

Emërtimi dhe Forma ligjore

Giobert Albania Sh.p.k

NIPT -i

L82016002E

Adresa e Selisë

Vrrinë, Njësia Administrative Rrashbull, Durrës

Durrës

Data e krijimit

16.08.2018

Nr. i Regjistrimit Tregtar

Veprimtaria Kryesore:

Shoqëria ka për objekt si në Shqipëri edhe jashtë saj, zhvillimin, edhe për të tretët, të industrisë mekanike dhe elektromekanike në përgjithësi; përpunimin e metaleve dhe lëndëve të para plastike; shkrirjen dhe përpunimin e materialeve lidhëse të lehta; montimin e produkteve dhe komponentëve; zhvillimin e trajtimeve si për shembull lyerjen dhe tampografinë e këtyre produkteve. Shoqëria, brenda limiteve të përcaktuara do të mund të përmbushi të gjithë veprimtarinë e nevojshme dhe të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë, duke përfshirë pasuritë e luajtshme, paluajtshme, tregtare përfshirë edhe krijimin e agjentëve, përfaqësuesve.

PASQYRAT FINANCIARE

(Në zbatim të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit Nr. 2; 15 dhe Ligjit Nr. 9228 Datë 29.04.2004 " Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare")

Viti 2021
01.01.2021-31.12.2021

Pasqyrat Financiare janë individuale

Po

Pasqyrat Financiare janë të konsoliduara

Jo

Pasqyrat Financiare janë të shprehura në

Lekë

Pasqyrat Financiare janë të rumbullakosura në

Lekë

Periudha Kontabël e Pasqyrave Financiare

Nga

01.01.2021

Deri

31.12.2021

Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare

31.03.2021

Pasqyrat financiare te vitit 2021

GIOBERT ALBANIA Sh.p.k

NUIS: L82016002E

Lek/Mije Lek/Miljon Lek

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhese
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	1,122,792	2,785,492
Investime		
<i>Te tjera financiare</i>		
Te drejta te arketueshme		
<i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	18,544,254	2,235,933
<i>Nga njesite ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Te tjera</i>	3,967,279	3,157,756
<i>Kapital i nenshkruar i papaguar</i>		
Inventaret		
<i>Mallra</i>		
<i>Aktive biologjike (gje e gjalle ne rritje dhe majmeri)</i>		
<i>AAGJM te mbajtura per shitje</i>		
<i>Parapagime per inventar</i>		
Shpenzime te shtyra		
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara		
Totali i aktiveve afatshkurtra	23,634,325	8,179,181
Aktive afatgjate		
Aktive financiare		
Aktive materiale		
<i>Toka dhe ndertesa</i>		
<i>Impiante dhe makineri</i>	18,240,501	22,201,824
<i>Te tjera instalime dhe pajisje</i>		
<i>AAGJM te mbajtura per investim</i>		
<i>Parapagime per aktive materiale dhe ne proces</i>		
Aktivitet biologjike		
Aktive jo materiale		
<i>Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme</i>	7,956,463	7,487,946
<i>Emri i mire</i>		
<i>Parapagime per AAJM</i>		
Aktivitet tatimore te shtyra		
Totali i aktiveve afatgjate	26,196,964	29,689,770
TOTALI I AKTIVEVE	49,831,288	37,868,951

DETYRIMET DHE KAPITALI**Detyrime afatshkurtra**

<i>Aktetime ne avance per porosi</i>	3,950,311	
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	17,493,458	16,216,287
<i>Deftesa te pagueshme</i>		
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *</i>	2,280,586	612,968
<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese</i>		
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	1,853,827	1,475,683
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>	135,521	148,832
<i>Te tjera te pagueshme</i>		
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
Te ardhura te shtyra		
Provizione	0	0
Totali i detyrimeve afatshkurtra	25,713,703	18,453,771

Detyrime afatgjata

<i>Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *</i>	67,575,600	69,222,000
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
Te ardhura te shtyra		
Provizione		
Detyrime tatimore te shtyra		
Totali i detyrimeve afatgjata	67,575,600	69,222,000

Detyrime totale

	93,289,303	87,675,771
--	-------------------	-------------------

Kapitali dhe Rezervat

Kapitali i nenshkruar	1,250,000	1,250,000
Primi i lidhur me kapitalin		
Rezerva rivleresimi		
Rezerva te tjera		
<i>Rezerva ligjore</i>		
Fitimi/(humbja) e pashperndare	(51,056,819)	(19,597,045)
Fitimi/(humbja) e periudhes	6,348,804	(31,459,775)
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike	(43,458,015)	(49,806,820)
Interesa jo-kontrollues		
Totali i kapitalit	(43,458,015)	(49,806,820)

TOTALI I DEYRIMEVE DHE KAPITALIT

	49,831,288	37,868,951
--	-------------------	-------------------

Pasqyrat financiare te vitit 2021

GIOBERT ALBANIA Sh.p.k

NUIS: L82016002E

Lek/Mije Lek/Milion Lek

Pasqyra e Performances (sipas natyres)

	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit		
<i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor</i>	102,000,256	41,915,783
<i>Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	4,734,729	
Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces		
Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar		
Te ardhura te tjera te shfrytezimit		
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	(2,880,062)	(1,058,869)
<i>Te tjera shpenzime</i>		
Shpenzime te personelit		
<i>Paga dhe shperblime</i>	(50,624,936)	(34,274,912)
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	(7,547,450)	(5,310,156)
<i>Shpenzimet per pensionet</i>		
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(6,094,865)	(6,293,046)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	(32,887,492)	(23,870,361)
Te ardhura te tjera		
<i>Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit*</i>		
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra		
Shpenzime financiare		
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme</i>	(1,682,187)	(1,045,349)
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme per tu paguar tek njesite ekonomike brenda grupit *</i>		
<i>Shpenzime te tjera financiare</i>	1,330,812	(1,522,865)
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet te tjera (pershkruaj)		
Fitimi/(humbja) para tatimit	6,348,804	(31,459,775)
Tatimi mbi fitimin		
<i>Tatimi mbi fitimin e periudhes</i>	0	0
<i>Tatim fitimi i shtyre</i>		
<i>Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve</i>		
Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)	6,348,804	(31,459,775)
Totali i te ardhurave gjithepershiresë per periudhen/vitin (A+B)	6,348,804	(31,459,775)

Pasqyrat financiare te vitit 2021

GIOBERT ALBANIA Sh.p.k

NUIS: L82016002E

Lek/Mije Lek/Miljon Lek

Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare(*metoda indirekte*)

	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
	2021	2020
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
Fitim / Humbja e vitit	6,348,804	-31,459,775
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin		0
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6,094,865	6,293,046
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme tregëtare dhe të tjera	-17,117,845	2,239,986
Rënie/(rritje) në inventarë	0	0
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme tregëtare dhe të tjera	1,263,860	-1,321,284
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	378,144	503,496
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	-3,032,172	-23,744,531
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	-1,581,555	-4,117,734
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	21,219	
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera	-1,020,504	-1,279,651
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera	0	
Dividentë të arkëtuara		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-2,580,840	-5,397,385
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		
Hua të arkëtuara	3,950,311	31,598,653
Pagesa e huave		
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		
Interes i paguar		
Dividendë të paguar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	3,950,311	31,598,653
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	-1,662,701	2,456,737
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	2,785,492	328,755
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	1,122,792	2,785,492

Pasqyrat financiare te vitit 2021

GIOBERT ALBANIA Sh.p.k

NUIS: L82016002E

Lek/Mije Lek/Milijon Lek

Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto

	Kapitali i nenshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Fitimet/ (humbjet) e pashperndara	Fitim/(humbja) e periudhes	Totali	Interesa jo- kontrollues	Totali
Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes)	1,250,000	0	0	(19,597,045)	(19,597,045)	0	(19,597,045)
Te ardhurat totale gjithepershires te periudhes:							
Fitim/(humbja) e periudhes					0		0
Te ardhura te tjera gjithepershires			0	(31,459,775)	(31,459,775)		(31,459,775)
Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejperdrejt ne kapital					0		0
Totali i te ardhurave gjithepershires per periudhen	0	0	0	(31,459,775)	(31,459,775)	0	(31,459,775)
Transaksione per pronaret e njesis ekonomike te njohura direkt ne kapital:							
Emetim i kapitalit te nenshkruar					0		0
Dividende te shperndare					0		0
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj)							
Totali i transaksioneve per pronaret e njesis ekonomike	0	0	0	0	0	0	0
Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes)	1,250,000	0	0	(51,056,819)	(49,806,819)	0	(49,806,819)

Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:					
Fitim/(humbja) e periudhes			0	0	0
Te ardhura te tjera gjithepershires		6,348,804	6,348,804	6,348,804	6,348,804
Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejtperdrejt ne kapital			0	0	0
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	0	6,348,804	6,348,804	6,348,804	6,348,804
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:					
Emetim i kapitalit të nënshkruar			0	0	0
Dividende te shperndare			0	0	0
Percaktime te tjera per rezultatit e periudhes <i>(pershkruaj)</i>			0	0	0
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	0	0	0	0	0
Pozicioni financiar ne fund (viti aktual)	1,250,000	0	(44,780,015)	(43,458,015)	0 (43,458,015)

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

1. Informacione të përgjithshme

Shoqëria tregtare “Giobert Albania” sh.p.k, është themeluar si një shoqëri me përgjegjesi të kufizuar më 16 gusht 2018. Administratorët e shoqërisë janë Z. Sebastiano La Ferla dhe Z. Claudio Fusero dhe vepron në përputhje me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjeve të tjera që rregullojnë biznesin në Shqipëri.

Kapitali rregjistruar i saj është 1,250,000 lekë dhe aktualisht zotërohet nga ortaku :

- 1- Giobert S.P.A – 100%

Veprimtaria kryesore e shoqërisë për ushtrimin 2021 ka qënë: zhvillimin, edhe për të tretët, të industrisë mekanike dhe elektromekanike në përgjithësi; përpunimin e metaleve dhe lëndëve të para plastike; shkrirjen dhe përpunimin e materialeve lidhëse të lehta; montimin e produkteve dhe komponentëve; zhvillimin e trajtimeve si për shembull lyerjen dhe tampografinë e këtyre produkteve.

Deklaratë e pajtueshmërisë me SKK-të

Pasqyrat financiare (individuale) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të), të përmirësuara, dhe me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera, dhe parimit të të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (lekë).

3. Politikave më të rëndësishme kontabël të zbatuara:

3.1 Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të shoqërisë dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitete financuese janë aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të shoqërisë.

3.2 Aktivitet dhe detyrimet financiare

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Matja fillestare e një aktivi financiar ose një detyrim financiar bëhet me

kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e aktivitetit financiar ose detyrimit financiar bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të periudhës raportuese, matja e instrumentave financiarë bëhet si vijon: Instrumentat e borxhit e percaktuara në pikën 7 dhe 8 të SKK-3 (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar, përveçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesi për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njihen menjëherë shuma për humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njohur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit financiar të debitorit), rimerret humbja nga zhvlerësimi të njohur më parë ose direkt ose duke rregulluar një llogari zhvlerësimi, në fitim ose humbje.

Aktivet dhe detyrimet financiar shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar në percaktimet e SKK-2.

3.3 Inventarët

Fillimisht, inventari njihet atëherë kur shoqëria e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit.

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngjashme (taksat e parimbursueshme).

Pas njohjes, inventari matet me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur.

Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit.

3.4 Shpenzimet e shtyra dhe të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave.

3.5 Aktivët afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale (AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse: aktiv i kontrollon nga shoqëria, është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivit të hyrë dhe kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfundimit të tij nga blerja apo prodhimi. Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, matet me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe e aplikon këtë model për të gjithë klasën e AAM-së që vlerësohet.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen koston së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, ajo vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivit. Nëse nuk ka të shenja për zhvlerësim, nuk është e nevojshme të vlerësohet shuma e rikuperueshme.

Vlera e amortizueshme e AAM-ve njihet në pasqyrën e të ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktiv. Përjashtime bëjnë aktivët afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për propojë), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me *metodën e vlerës së mbetur*, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivët në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura janë në ndërtesa 5 %, pajisjet informatike 25% dhe për aktivët e tjera 20% të vlerës së mbetur.

3.6 Aktivët afatgjata jomateriale

Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse: është e mundur që të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri dhe aktiv i nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda shoqërisë për një zë jomaterial. Njohja fillestare e një aktiv jomaterial bëhet me kosto, ndësa vlerësimi i mëpasshëm paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

3.7 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Matja e të ardhurave bëhet me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren; kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen kur: shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në

shoqëri; faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri; kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi nga palë të treta i aktiveve të saj që sjellin interes, përfitim pagesash për përdorime të pronës (rojëllti) dhe dividendë njihen si më poshtë: të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e brendshme të interesit efektiv; të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëllti) njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me kushtet e kontratës; të ardhurat nga dividendët njihen kur aksionari ka të drejtë ligjore për ta arkëtuar atë (dividendin).

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar.

3.8 Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotësojnë kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zërat në monedhë të huaj përkthehen si më poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin.

Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2021 janë 1 euro=120.76 lekë.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor në pasqyrën e performancës, përveç tatimit të zërave që njihen direkt në kapital, i cili njihet si një zë i kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet në vlerat që shoqëria pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatimore dhe ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuara në datën e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor të shtyrë njihet për tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar dhe

njohjes së këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2021 është 15 % aq sa ka qënë në ushtrimin e mëparshëm.

4. Mjete Monetare (likujditete në arkë, bankë etj.)

Gjëndjet e mjeteve monetare në bankë dhe arkë, në fillim dhe fund të ushtrimit janë si më poshtë:

Nr	Përshkrimi i elementeve	Monedha	Periudha raportuese	Periudha paraardhëse
1	Mjete monetare në arkë	Lekë	99,901	9,298
2	Mjete monetare në arkë	Euro	8,586	0
2	Mjete monetare në bankë	Lekë	396,337	2,403,357
3	Mjete monetare në bankë	Euro	617,968	372,837
Shuma			1,122,792	2,785,492

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të shpallur nga Banka e Shqipërisë me 31.12.2021.

5. Të Drejta të Arkëtueshme Afatshkurtëra

Të drejtat e arkëtueshme, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël deklarohen si vijon:

Nr	Përshkrimi i elementeve	Periudha raportuese	Periudha paraardhëse
1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit	18,544,254	2,235,932
2	Të tjera	3,967,279	3,157,756
3	Shpenzime të shtyra	0	0
Shuma		22,511,533	5,393,688

Në “Nga Aktiviteti i Shfrytëzimit (Klientë)” janë pasqyruar faturat ende pa paguar nga shitjet që shoqëria ka kryer gjatë vitit.

Ndërsa në “Të Tjera” janë pasqyruar kërkesat debitore ndaj Tvsh, Tatimit mbi Fitimin, taksave doganore dhe parapagimeve të tjera.

Drejtimi mendon se të gjitha kërkesat do të arkëtohen në një periudhë afatshkurtër me vlerën e tyre nominale dhe nuk parashikon rënie në vlerë.

6. Inventari

Nuk janë evidentuar inventarë në fund të ushtrimit.

7. Shpenzime të Shtyra

Në vitin 2021 nuk janë evidentuar shpenzime të shtyra.

8. Aktive Afatgjata Financiare

Nuk janë evidentuar Aktive Afatgjata Financiare në fund të ushtrimit.

9. Aktivet Afatgjata

Aktivët afatgjata materiale përfaqësojnë vlerën neto të AAM, duke i zbritur amortizimin e akumuluar deri në fund të ushtrimit:

Nr	Përshkrimi i elementeve	Periudha raportuese	Periudha paraardhëse
1	Aktive Afatgjata Materiale	18,240,501	22,201,824
2	Aktive Afatgjata Jomateriale	7,956,463	7,487,946
	Shuma	26,196,964	29,689,770

AAM-të, që plotësojnë kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, janë matur me kosto.

Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe në pasqyrën e pozicionit financiar AAM-të janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Vlerat dhe klasifikimi në grupe të AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mësipërmë janë të përputhura me të dhënat e inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit Dhjetor 2021.

Metoda e zgjedhur e amortizimit të AAM-ve është metoda mbi vlerën e mbetur. Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Drejtimi mendon se përgjithësisht në këtë ushtrim kontabël, nuk ka shenja të rënies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime.

AAJM-të, që plotësojnë kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, janë matur me kosto.

10. Detyrime Afatshkurtëra

Detyrimet afatshkurtra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2021 paraqiten:

Nr	Përshkrimi i elementeve	Periudha raportuese	Periudha paraardhëse
1	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	17,493,458	16,216,287
2	Të pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit	2,280,586	612,968
3	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore	1,853,827	1,475,683
4	Të pagueshme për detyrime tatimore	135,521	148,832
5	Aktetime në avance për porosi	3,950,311	0

6	Provizione	0	0
	Shuma	25,713,703	18,453,771

“Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit (furnitorë)” rezulton me gjendje në fund të ushtrimit 17,493,458 lekë.

“Të pagueshme ndaj njesive ekonomike Brenda grupit” rezulton me gjendje në fund të ushtrimit 2,280,586 lekë, që përfaqëson shumën e interesit të pagueshëm kundrejt shoqërisë mëmë.

“Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet.” paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj personelit dhe detyrimin e muajit Dhjetor 2021.

“Të Pagueshme për Detyrime Tatimore” përbëhet nga tatimi në burim që do të paguhet në vitin 2021.

“Aktetime ne avance per porosi” paraqet detyrimet e mbetura te shoqerise kundrejt porosive te pa realizuara.

12. Detyrimet Afatgjata

Detyrimet afatgjata në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2021 paraqiten:

Nr	Përshkrimi i elementeve	Periudha raportuese	Periudha paraardhëse
1	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit	67,575,600	69,222,000
	Shuma	67,575,600	69,222,000

Shoqëria ka detyrime afatgjata ndaj grupit për vlerën 67,575,600 lekë. Këto janë detyrime që do të shlyhen për një periudhë më të gjatë se një vit.

13. Kapitali dhe rezervat

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar, është i njëjtë me atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara në QKR.

Nuk ka pasur ndryshime në kapitalin e regjistruar për vitin ushtrimor.

14. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera

Nr	Përshkrimi i elementeve	Periudha raportuese	Periudha paraardhëse
1	Të ardhura nga aktiviteti kryesor	102,000,256	41,915,783
2	Të ardhura të tjera	4,734,729	0
	Shuma	106,734,985	41,915,783

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja. Te ardhurat e tjera me vlere 4,734,729 perfshijne te ardhurat nga rishikimi i tarifës për vlerën e punës dhe shitja e aktiveve të qendrueshme.

Paraqitja në pasqyrat financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve është bërë sipas natyrës së tyre.

15. Shpenzimet e për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme

Nr	Përshkrimi i elementeve	Periudha raportuese	Periudha paraardhëse
1	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	(2,880,062)	(1,058,869)

2	Të tjera shpenzime		0
	Shuma	(2,880,062)	(1,058,869)

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë regjistruar me shumata e paguara ose të pagueshme.

16. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbehen nga pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, leja vjetore e paguar, raporti mjekësor i paguar në 14 ditët e para, pjesëmarrja në fitime dhe shpërblimet.

Numri mesatar i punonjësve dhe shpenzimet vjetore të kryera për personelin janë si më poshtë :

Nr	Përshkrimi i elementeve	Periudha raportuese	Periudha paraardhëse
1	Paga dhe shpërblime	(50,624,936)	(34,274,912)
2	Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	(7,547,450)	(5,310,156)
	Shuma	(58,172,386)	(39,585,068)

Numri mesatar i punonjësve për vitin 2021 është: 94 punonjës

Kostoja e punësimit, page dhe sigurime shoqërore, është pasqyruar saktësisht si shpenzim me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar.

17. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Në shpenzime të tjera të shfrytëzimit janë përfshirë kostot e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, që lidhen drejtpërdrejt me veprimtaritë e shfrytëzimit dhe ato për qëllime administrative, si dhe, kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit.

Nr	Përshkrimi i elementeve	Periudha raportuese	Periudha paraardhëse
1	Blerje /shpenzime te materialeve	(487,200)	0
2	Energji, avull, ujë	(1,355,452)	(1,004,181)
3	Blerje te pastokueshme	(248,800)	(147,450)
4	Blerje /shpenzime te tjera		
6	Sherbime Doganore	(1,786,740)	(926,840)
7	Sherbime nga te tretet	(7,034,546)	(3,751,327)
8	Qira	(6,367,321)	(7,456,750)
9	Mirembajtje dhe riparime	(637,647)	(479,134)
10	Sigurime	(284,677)	(290,851)
11	Te tjera	(1,445,895)	(2,191,548)
12	Shpenzime kancelari	(923,080)	(559,008)
13	Sherbime bankare	(523,506)	(302,959)
14	Personel nga jashte ndermarjes	(262,648)	(250,049)
15	Transferime, udhetim, dieta	(643,847)	(382,742)
16	Shpz.postare e telekom.	(433,438)	(561,472)
17	Transporte per blerje	(4,276,171)	(740,323)

18	Transporte per shitje		
19	Per personelin	(2,295,000)	(1,226,100)
20	tatime, taksa mbi porosite	(190,852)	(100,765)
21	Taksa dhe tarifa vendore		(5,000)
22	Tatime te tjera	(1,000)	(1,753)
23	Shpenzime te tjera per personelin	0	0
24	Shpenzime per pritje dhe perfaqesime	(272,570)	(80,710)
25	Gjoha dhe demshperblime	(12,339)	(70,277)
26	Shpenzime te tjera	(1,263,953)	(1,065,609)
27	Karburant	(2,110,810)	(2,254,512)
28	Provizion per qerane	0	0
29	Provizion uje dhe energji	(30,000)	(21,000)
	Shuma	(32,887,492)	(23,870,361)

Shpenzime të tjera shfrytëzimi përbëhen kryesisht nga blerjet e nevojshme për të mbështetur mbarëvajtjen e aktivitetit kryesor, të tilla si, energji, mirëmbajtje, qira, blerje materiale, internet, shërbime transporti, etj. , të detajuara në tabelën e mësipërme në dy periudha ushtrimore.

18. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Nr	Përshkrimi i elementeve	Periudha raportuese	Periudha paraardhëse
1	Interesa të pagueshëm	(1,682,187)	(1,045,349)
2	Diferenca të këmbimit	1,330,812	(1,522,865)
	Shuma	(351,375)	(2,568,213)

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përbëhen nga dy zëra, interesat e pagueshëm dhe diferencat nga kursi i këmbimit për transaksionet në valutë dhe nga përkthimi në monedhën e paraqitjes në mbyllje të vitit ushtrimor. Interesat e pagueshëm janë përlogaritur në bazë të planit të amortizimit të huave që shoqëria ka marrë nga shoqëria e saj mëmë dhe sipas kontabilitetit rrjedhës, pra përfaqësojnë shumën e interesave të maturuar deri më 31.12.2021. Diferencat e këmbimit janë paraqitur për shumën e tyre neto si diferencë e të ardhurave me shpenzimet sipas kërkesave të standardeve.

19. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregulloret shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Nr	Përshkrimi i elementeve	Periudha raportuese	Periudha paraardhëse
1	Humbje fiskale e mbartur	(43,458,015)	(12,374,600)
2	Fitimi/humbja e periudhës	6,348,804	(31,459,775)
3	Shpenzime te panjohura	3,417,102	3,411,398
4	Fitim/Humbja Tatimore	9,765,907	(28,048,376)
5	Tatimi mbi fitimin	0	0

6	Fitim/Humbja neto e vitit financiar	6,348,804	(31,459,775)
---	-------------------------------------	-----------	--------------

Në tabelën e mësipërme janë pasqyruar përbërësit më kryesorë të fitimit të tatueshëm i cili për vitin 2021 rezulton në vlerën 9,765,907. Tatim fitimi tatimor për vitin 2021 është zero pasi është perlllogaritur edhe humbja e dy viteve të fundit.

Në llogaritjen e shpenzimit aktual të tatimit mbi fitimin janë respektuar kërkesat e legjislacionit fiskal për të ardhurat e tatueshme dhe shpenzimet e panjohura. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15%.

20. Shifrat krahasuese

Pasqyrat financiare të vitit 2021 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhënë në shtojcën e standardit SKK-2, (të përmirësuar) dhe çeljet e vitit 2020 janë paraqitur sipas këtyre zërave.

21. Ngjarjet pas dates së bilancit dhe vazhdimësia e shfrytëzimit

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

Administratori



Hartuesi/Financieri



